

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“DPM Albania”

Unë Erta Xhanari, e bija e Asqerit, dtl 31.05.1988, me numer personal I85531065C,
banues Rr: Zef Jubani, Pallati Merkaj, ap 14, Tirane

Dhe

Unë Doniano Xhanari, i biri i Asqerit, dtl 21.03.1992, me numer personal J20321072G
banues Rr: Zef Jubani, Pallati Merkaj, ap 14, Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në
Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë
31.10.2022, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “DPM Albania”, me aktin
themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “DPM Albania” Shoqëria do të nënshtrohet
legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të
ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të
shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private “DPM Albania”. do të jetë :

Njesia bashkiake nr 2, Rruga Abdi Kazani, Pallati nr 34, kati 2, Hyrja nr 1, Tirane
Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci oprative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

Import-eksport, shitje me shumice dhe pakice te produkteve dentare, kozmetike, pajisjeve dhe materialeve dentare etj. Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, lëndë të para. Import Eksport te Pajisjeve Mjeksore

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "DPM Albania " do të jetë **10,000** (dhjet mije) lekë. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga **2** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **5,000** lekë.

Znj. Erta Xhanari zotron 1 kuote me vlere 5,000 leke qe perben 50% te kapitalit themeltar
Z. Doniano Xhanari zotron 1 kuote me vlere 5,000 leke qe perben 50% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Doniano Xhanari i cili është edhe përfaqësuese ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhe kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë, Znj. Erta Xhanari dhe Z. Doniano Xhanari 50/50.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14


Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare “DPM Albania”

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“DPM Albania”

ERTA XHANARI

ERTA XHANARI


DONIANO XHANARI

Doniano Xhanari
